

Manuali i përdorimit

Kyqja në platformë dhe nënshkrimi elektronik brenda platformës
rTrust

1. Hyrje

- **Qka është rTrust?**

rTrust është autoritet certifikues për lëshimin e nënshkrimit elektronik, vulës elektronike, certifikatës elektronike, identitetit digjital për qytetarë, biznese dhe ueb server, konform kornizës ligjore në fuqi në vendin tonë si dhe eIDAS Rregullores 910/2014 të BE-së, e cila përcakton standartet për shërbimet e besueshme elektronike.

- **Qellimi i manualit**

Ky manual është krijuar për të udhëhequr përdoruesit përmes procesit të kyqjes në platformën tonë dhe për të ndihmuar në procesin e nënshkrimit elektronik.

Duke ndjekur këtë udhëzues hap pas hapi, do të jeni në gjendje të:

1. **Kyqeni në platformë.**
2. **Nënshkruani dokumentet përmes nënshkrimit elektronik brenda platformës rTrust.**

Ky manual synon t'i bëjë proceset e kyqjes dhe nënshkrimit elektronik sa më thjeshtë që të jetë e mundur.

Nëse hasni ndonjë problem ose keni nevojë për ndihmë të mëtejshme, ju lutemi kontaktoni ekipin tonë të mbështetjes duke përdorur informacionin e dhënë në fund të këtij manuali.

2. Procesi i nënshkrimit elektronik hap pas hapi

- **Hapi 1: Qasja në platformë**

Për të hyrë në Platformë, duhet të përdorni url-në e mëposhtme nga një shfletues në një kompjuter personal ose një pajisje celulare (tablet ose smartphone): <https://rtrust.org>

- **Hapi 2: Klikoni në butonin Kyqu.**

Lexoni për arritjet e shumta në blogun tonë →

Identitet Digjital që njihet në gjithë Zonën Ekonomike Evropiane

Krijo identitetin tuaj digjital që njihet në gjithë Zonën Ekonomike Evropiane dhe në Republikën e Kosovës. Identiteti digjital është parakusht për nënshkrime elektronike, vula elektronike dhe autentikim në ueb faqe. Identiteti digjital krijohet në harmoni me rregulloren e Bashkimit Evropian eIDAS 910/2014, për çka SLOTES by PBC mban certifikatën numër eIDAS-007/2023.



Të besuar nga shumë biznese



Figura 1. Faqja kryesore

- Hapi 3: Shkruani email adresën tuaj dhe klikoni në butonin **Kyçu me Email**.





Figura 2. Forma për login

- **Hapi 4:** Pasi klikoni në butonin **Kyqu me email**, në emailin e ofruar ju do të pranoni një email nga ekipi i rTrust, dhe duhet të klikoni në butonin **Hyni në llogarinë tuaj**.



I/e dashur John,

Ne kemi marrë një kërkesë për t'u identifikuar në llogarinë tuaj në faqen tonë të internetit.
Për të hyrë në llogarinë tuaj, ju lutemi klikoni link-un më poshtë:



Nëse nuk keni mundur të identifikoheni në llogarinë tuaj, ju lutemi kontaktoni ekipin tonë të mbështetjes së klientit. Mund të na kontaktoni me telefon në +383 38 600 200 ose me email në Certifikata@rtrust.org.

UKITES BY PBC LIMITED - SLOTES
Kotnikova Ulica 5, 1000 Ljubljana, SLOVENIA

*Ky është një email i automatizuar. Ju lutemi mos iu përgjigjini kësaj adrese emaili.

Figura 4. Email nga ekipi rTrust

- **Hapi 5:** Për të nënshkruar një dokument, ju duhet të klikoni në **Nënshkruaj vetë**.




Figura 5. Dashboard

- **Hapi 6:** Për të ngarkuar dokumentin që dëshironi të nënshkruani klikoni fillimisht mbi butonin **Zgjedh dokumentin**, pastaj pasi që të ngarkoni dokumentin klikoni butonin **Vazhdo**.




Figura 6. Forma për ngarkimin e dokumentit

- **Hapi 7:** Pasi klikoni vazhdo, ju shfaqet dokumenti i ngarkuar. Ju tani duhet të tërhiqni fushën **Nënshkrimi** dhe ta vendosni mbi dokument, aty ku dëshironi të nënshkruani, ose të caktoni hapsirën ku të tjerët kanë për të nënshkruar.




Figura 7. Shtimi i formës së nënshkrimit brenda dokumentit

- **Hapi 8:** Pasi të e poziciononi fushën, klikoni mbi të dhe zgjedhni se kush dëshironi të nënshkruan aty.




Figura 9. Zgjedhja e personi për nenshkrim

- **Hapi 9:** Nëpërmjet opsionit **Shkruaj**, mund të shkruani emrin ose inicialet. Nëse dëshironi të vizatoni nënshkrimin tuaj, atëherë mund ta përdorni opsionin **Vizato**. Nëse keni ndonjë foto të mbishkrimit, atëherë mund të përdorni opsionin **Ngarko**. Pasi të zgjedhni formën e dëshiruar klikoni në butonin **Nënshkruaj**.




Figura 9.

- **Hapi 10:** Pasi klikoni **Nënshkruani**, nënshkrimi ju shfaqet në këtë formë. Për të vazhduar ju duhet të klikoni në butonin **Kompleto**.




Figura 10.

- **Hapi 11:** Tani ju shfaqet forma për vendosjen e **fjalëkalimit** tuaj. Pasi të shkruani fjalëkalimin klikoni butonin **Vazhdo**.




Figura 11.

- **Hapi 12:** Dokumenti është nënshkruar me sukses, nëse dëshironi të shikoni dokumentet që keni nënshkruar duhet të klikoni te butoni **Shko te dokumentet**, ndërsa nëse dëshironi të shkarkoni dokumentin së bashku me nënshkrimin elektronik klikoni në butonin **Shkarko**.




Figura 12.

3. Informacioni i kontaktit për mbështetje

Email: certificates@rtrust.org

Numri i telefonit: +383 49 247 857

3.1. Personi kontaktues për mbrojtjen e të dhënave personale

Endrina Ramadani

Email: er@rtrust.org